PROCESVERBAL

Nga senca e dytë e jashtëzakonshme e këshillit të mbajtur me datë03.03.2023, me fillim në ora 10:00, në sallën e komunës së Zhelinës në presence të antarëve të këshillit.

Seancën e hapi Kyetrai I këshillit Bujar Baftjari dhe prezantoi propoyimin e rendit të ditës me nr. Arkivor 08-349/1 në përbërje prej 6 pikave:

R E N D D I T E

1. Propozim-Vendim për përkrahje financiare të të dëmtuarëve nga tërmeti në Turqi dhe në Siri.
2. Propozim- Vendim për ndryshimin e Vendimit për realizimin e Buxhetit të komunës së Zhelinës për vitin 2023-të.
3. Propozim –Vendim për dhënie Pëlqim Planit financiar të Ndërmarrjes publike komunale " Mirëmbajtja" – Zhelinë, f. Zhelinë për vitin 2022-të.
4. Propozim- Vendim për dhënie pëlqim të llogarisë përfundimtare të Ndërmarrjes publike komunale " Mirëmbajtja" – Zhelinë, f. Zhelinë për vitin 2022-të.
5. Propozim- Vendim për mbartjen e kompetencave dhe përgjegjësive për ekonomizimin me rrjetin e ujësjellsinë Shoqatës së qytetarëve Llokojca-f. Llukovicë- komuna e Zhelinës.
6. Shqyrtimi i kërkesës nr. 08-297/1 i datës 23.02.2023-të, nga Bashkësia lokale e f. Stremnicë

Pas prezantimit të rendit të ditës, Kryetari i këshillit Buajr Baftjari rendin e ditës e hodhi në votim dhe shpjegoi arsyen e kësaj seance të jashtëzakonshme, më pas rendin e ditës e hodhi në votim, u votua unanimisht.

Kryetrai i këshillit e hapi seancën.

1. Propozim-Vendim për përkrahje financiare të të dëmtuarëve nga tërmeti në Turqi dhe në Siri.

Kryetari i këshillit hapi diskutim, fjalën e mori këshilltari Atnan Ilazi.

Atnat I: Për këtë rast propozoj një shumë prej treqind mijë denarësh.

Pas këshilltarit Atnan I, fjalën e mori këshilltari Sheval Sulejmani.

Sheval S: Mendoj që kjo pikë është me vonesë, duke marrë parasysh gjendjen e komunës, për këtë vler që e ka prpozuar këshilltari Atnan I. Dikush nga administrata e komunës sesa ka mundësi komuna ta përballoj këtë shumë.

Adil Emini nga Sektori për Financa dha informacionet e duhura.

Pas sqarimeve Kryetari pikën e parë bashkë me propozimin e këshilltarit Atnan I. E hodhi në votim, ku me 11 vota pro, asnjë kundër dhe 7 të përmbajtur konstatoi se kjo pikë kalon.

2. Propozim- Vendim për ndryshimin e Vendimit për realizimin e Buxhetit të komunës së Zhelinës për vitin 2023-të.

Meqë nuk pati diskutim këtë pikë Kryetari i këshillit e hodhi në votim, ku me 10 vota pro, asnjë kundër dhe 8 të përmbajtur konstatoi se kjo pikë kalon.

3. Propozim –Vendim për dhënie Pëlqim Planit financiar të Ndërmarrjes publike komunale " Mirëmbajtja" – Zhelinë, f. Zhelinë për vitin 2022-të.

Kryetari i këshillit hapi diskutim, fjalën e mori këshilltari Rian Amiti.

Rian A: Në seancën e parë kërkuam që të ketë reduktime në disa pika, pastaj në seancne dytë erdh i njëjti plan, pasi kjo seancë me theks të veçantë mendoj se e ka këtë pikë.

Pas diskutimeve këtë pikë Kryetari i këshillit e hodhi në votim, ku me 11 vota pro, 1 kundër dhe 6 vota të përmbajtur konstatoi se kjo pikë kalon.

4. Propozim- Vendim për dhënie pëlqim të llogarisë përfundimtare të Ndërmarrjes publike komunale " Mirëmbajtja" – Zhelinë, f. Zhelinë për vitin 2022-të.

Kryetari i këshillit hapi diskutim, fjalën e mori Naser Mislimi.

Naser M: Kjo kërkon më shumë kohë për t'u shqyrtuar nga ne, mendoj se kjo pikë nuk është dashtë që të vendoset në këtë seancë.

Pastaj fjalëne mori këshilltari Sheval Sulejmani.

Sheva S: Nuk është e arsyeshme aspak që të kemi një llogari përfundimtare mendoj se duhet të elaborohet e të sqarohet më tepër. Këekoj nga drejtori Suad Alili që të na elaboron gjendjen financiare të paraqitur.

Suad Alili Drejtori i Ndërmarrjes i dha sqarimet.

Pas sqarimeve Kryetari i këshillit këtë pikë e hodhi në votim, ku me 10 vota pro,8 kundër dhe asnjë të përmbajtur konstaoi se kjo pikë kalon.

5. Propozim- Vendim për mbartjen e kompetencave dhe përgjegjësive për ekonomizimin me rrjetin e ujësjellsinë Shoqatës së qytetarëve Llokojca-f. Llukovicë- komuna e Zhelinës.

Kryetari i këshillit meqë nuk pati diskutim këtë pikë e hodhi në votim, ku me 1 votë për, asnjë kundër dhe 17 të përmbajtur konstaoi se kjo pikë nuk kalon.

6. Shqyrtimi i kërkesës nr. 08-297/1 i datës 23.02.2023-të, nga Bashkësia lokale e f. Stremnicë

Kryetari i këshillit hapi diskutim, fjalën e mori këshilltari Naser Mislimi.

Naser M: Kjo kërksë ka një kundër ankesë dhe kërkoj të mos votohet.

Më pas Kyetari i këshillit këtë pikë e hodhi në votim, ku me 18 vota të përmbajtur, asnjë për dhe asnjë kundër konstatoi se kjo pikë nuk kalon.

Nr.08-349/2
03.03.2023-të
Zhelinë

Procesverbalist
Albineta Alija

Këshilli i komunës së Zhelinës
Kryetar
Bujar Baftjari